



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2024

Lënda: Gjuhë Shqipe

Udhëzime për nxënësin:

Testi përmban gjithsej **50 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **25 pyetje**.

Për pyetjet me alternativa rrethoni vetëm përgjigjen e saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6
Pikët						
Kërkesa	7	8	9	10	11	12
Pikët						
Kërkesa	13	14	15	16	17	18
Pikët						
Kërkesa	19	20	21	22	23	24
Pikët						
Kërkesa	25a	25b	25c	25d		
Pikët						

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1 Anëtar

2 Anëtar

“Dhjeta” e mësueses

Të gjithë vendasit tashmë ishin nxënës të Tersilës, mësueses së vjetër, që të gjithë e thërrisnin “Zonja”. Askush nuk dinte se sa vjeç ishte ajo, sigurisht shumë, por pamja e saj tregonte një freski ngjyrash dhe shpirti, një mirësi të madhe.

Në mbrëmje, pas darke, Zonja korrigjonte detyrat e nxënësve. Për të ai ishte momenti më i bukur i ditës. Nëse mbyllte sadopak sytë, përfytyronte të kishte përreth të gjithë nxënësit e saj, që ishin shumë të urtë. Një mbrëmje, teksa korrigjonte, dëgjohet një e trokitur në derë.

- Hyr, hyr! -përgjigjet ajo pa u kthyer për të parë se kush ishte.
- Një burrë me flokë të kuqe dhe të shpupuritura, me një vështrim dyshues, hyn brenda. Zonja kthehet për ta parë dhe, duke mos e njohur si vendali, u hutua.

- Keni nevojë për mua? Uluni ju lutem. Isha duke korrigjuar detyrat e fëmijëve të mi.

Afrohuni! Mos u druani! Unë po përfundoj së korrigjuari detyrat. Ju mund të më thoni se me çfarë mund t'ju ndihmoj.....

I huaji u ul dhe priste në heshtje. Mësuesja mori një fletë, e lexoi dhe tha:

- Të shohim tani Durantin.... E njihni këtë arush të vogël? Është i fortë sa një lis, nopran si një iriq, por çfarë zemre që ka! Askush nuk e di shtëpinë e tij. Ai vjen nga larg çdo mëngjes, me copën e tij të bukës në njëren dorë dhe librin në tjetrën. Bie shi, borë apo bën kohë e mirë, ai nuk mungon asnjë ditë. Thonë se është djali i një njeriu që.....jeton si të mundë. Por..... çfarë zgjuarsie ka ky djalë!

Ndërsa i huaji vështronte i habitur, mësuesja vazhdoi leximin e detyrës së Durantit.

- Babai im e dashuron tokën, e punon atë duke kënduar. Është i bukur dhe bujar; nuk e kam dëgjuar asnjëherë të thotë një fjalë të keqe. Unë shpesh e ndihmoj duke i afruar veglat e punës, duke i sjellë kovën me ujë të freskët, që të çlodhet nga vapa e madhe.

Mësuesja ktheu fletën dhe i doli një britmë gati zemërthyer:

- Jo, Durant, kjo njollë nuk duhej! Zelli ka rëndësinë e vet. Do të kisha vënë dhjetë, por nuk do marrësh më shumë se nëntë... .

Njeriu, i cili deri në atë moment kishte heshtur, mori kuroja dhe tha:

- Vëri dhjetë, Zonjë!

Zonja e pa me habi.

- Atë njollë e ka bërë për fajin tim!

- Për fajin tuaj? Po përse?

- Është djali im. Ai ka thënë për mua atë çfarë ai dëshiron që unë të jem dhe jo atë që jam. Nuk kam tokë që ta kultivoj e as që ta punoj me kënaqësi. Nuk i kam dhënë asgjë djalit tim për të merituar dashurinë e tij. Unë nuk e njihja zemrën e tij, ashtu siç e njihni ju. Lërmëni të iki! Erdha këtu, por nuk e dija se do të takoja djalin tim.

Mësuesja e vjetër vendosi një dhjetë të bukur të kuqe mbi detyrën e Durantit.

- Merreni! Çojani këtë fletë djalit tuaj!

Mësuesja ngriti kandilin për t'i bërë dritë njeriut që po dilte. Pastaj rifilloi korrigjimin e detyrave, por më parë, iu desh të thante sytë nga lotët.

Marrë nga libri “Tregime për fëmijë dhe të rinj”, Sterio Spase

1. Mësuesja nuk donte t'i vinte më shumë se nëntë Durantit, sepse ai:

1 pikë

- A) kishte shkruar me gabime.
- B) kishte gënjyer për babanë e tij.
- C) kishte njollë në fletën e detyrës.
- D) kishte ngatërruar kërkesën.

-
2. Në cilën nga alternativat e mëposhtme është përdorur kuptimi i figurshëm? **1 pikë**
- A) E njihni këtë arush të vogël?
B) Unë po përfundoj së korrigjuari detyrat.
C) Keni nevojë për mua?
D) Është djali im.
3. Cili është kuptimi i fjalisë: "Erdha këtu, por nuk e dija se do të takoja djalin tim."? **1 pikë**
- A) Babai takoi djalin e tij pas shumë kohësh.
B) Babai kërkoi djalin e humbur.
C) Babai kuptoi se nuk e njihite të birin.
D) Babai takoi djalin në shtëpinë e mësueses.
4. Në fjalinë: "Është i fortë sa një lis, nopran si një iriq, por çfarë zemre që ka!", fjala nopran ka kuptim: **1 pikë**
- A) i dashur.
B) i sjellshëm.
C) i prapë.
D) I vogël.
5. Figura letrare e përdorur në fjalinë: "Askush nuk dinte se sa vjeç ishte ajo, por pamja e saj tregonte një mirësi të madhe.", është: **1 pikë**
- A) metaforë
B) krahasim
C) antitezë
D) hiperbolë
6. Në fjalinë: "Çojani këtë fletë djalit tuaj!" folja është në mënyrën: **1 pikë**
- A) dëftore.
B) dëshirore.
C) urdhërore.
D) lidhore.
7. Në fjalinë "Nuk e kam dëgjuar asnjëherë të thotë një fjalë të keqe." fjala "asnjëherë" është: **1 pikë**
- A) e parme.
B) e prejardhur.
C) e përngjitur.
D) e përbërë.
8. Cila nga alternativat e mëposhtme është fjali e përbërë? **1 pikë**
- A) Askush nuk e di shtëpinë e tij.
B) Zelli ka rëndësinë e vet.
C) Nuk e dija se do të takoja djalin tim.
D) Isha duke korrigjuar detyrat e fëmijëve të mi.

9. Fjalja: "Keni nevojë për mua?" është: 1 pikë

- A) nxitëse.
- B) dëftore.
- C) pyetëse.
- D) dëshirore.

10. Mbështetur në fragmentin e mësipërm, shkruani dy cilësi të mësueses. 2 pikë

11. Si e kuptoni fjalinë: "Bie shi, borë apo bën kohë e mirë, ai nuk mungon asnjë ditë."? 2 pikë

12. Renditni dy nga cilësitë me të cilat Duranti përshkruan babanë në detyrën e tij? 2 pikë

13. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalinë: "E njihni këtë arush të vogël?" 3 pikë

E _____
këtë _____
të vogël _____

14. Shkruani tri fjalë të përngjitura të përdorura në tekst. 3 pikë

15. Përcaktoni funksionin e fjalëve në fjalinë: "Në mbrëmje, pas darke, Zonja korrigjonte detyrat e nxënësve." 4 pikë

në mbrëmje _____
detyrat _____
e nxënësve _____
pas darke _____

16. Shkruani me fjalë numërorët.

4 pikë

13 _____


39 _____

527 _____

1278 _____

17. Formoni dhe shkruani një fjali sipas skemës.

3 pikë



Letër nga fshati

Sokol!

Letrën ta vonova, se të prisnim, por ti s'passe mundësi që të na vish. Tani do të të tregoj diçka për fshatin tim. Merr me mend një liqen të bukur, rrethuar me male të larta e të bleruara në dimër e verë. Merr me mend edhe një vargmal, siç është Mali i Thatë dhe në këmbë të tij një fushë që shtrihet tatëpjetë e vjen e uthet me ujërat e liqenit. Merr me mend se nga kjo fushë shkapet një gadishull që futet edhe më thellë në liqen. Këtu është fshati ynë, Kallamasi ynë. Me të vërtetë natyrën e kemi shumë të bukur dhe të gjithë miqtë që na vijnë, mbeten gojëhapur. Ujërat e liqenit na rrethojnë nga të tria anët e ne jemi bërë shokë që në foshnjëri me këto ujëra. Kushedi sa herë i kam vajtur nënës në shtëpi si pulë e lagur. Ajo e shkreta më rrëmbente, më shtrëngonte në gji e shpejt m'i ndërronte rrobat. Një marrëzi të tillë e bëra edhe vjet. E që thua ti, më thërret Pirroja i gëzuar që të shkonim të luanim te Lëndina e Kosornikut. E ne aty vajtëm. Na erdhi edhe Vasoja, edhe Gjergji, edhe Todri. Filluam lojën. Po do ti, i jap një shkelm të fortë e fërr..... topi mu në mes të liqenit. Po tani? Mua sa s'më ra pika! Nuk m'u durua: mbylla sytë e u futa në ujë. E di ti? Me gjithë rroba! Topin e shpëtova, por unë u bëra gazi i shokëve.

Ja kështu na gënjen liqeni, të tilla ngatërresa kemi me të. Jo vetëm verës, por edhe dimrit jemi miq me liqenin. Na pëlqen shumë edhe kur është i zemëruar me ato dallgët e shkumëzuara e të tërbuara. E di ti ç'bëjmë ne? Vemi në zallishte dhe përpiqemi të gënjejmë dallgët. Kur tërhiqet dallga nga bregu, ne e ndjekim valën në thellësi. Kur fryhet ajo si e zemëruar, ne rendim të largohemi. Por shpesh herë ajo na mund: se si na gënjen e sakaq me plluq-plluq na mbushen këpucët me ujë. Ne shkulemi së qeshuri! Duke dashur që t'i largohemi sa më shpejt dallgës, pengohemi dhe bëldum biem në ujë. Dallga na kalon mbi trup dhe na bën qull.

Por fshati ynë ka dhe bukuri të tjera; për këto do të të shkruaj herë pas here. Mos harro dhe ti: dua të më shkruash me gjatë për fshatin tënd.

Mirupafshim!

Ylli

18. Teksti i dhënë është:

1 pikë

- A) letër personale.
- B) letër zyrtare.
- C) ftesë.
- D) ditar.

19. Cila nga fjalitë e tekstit tregon se fshati ka bukuri mahnitëse?

1 pikë

- A) Me të vërtetë... të gjithë miqtë që vijnë, mbeten gojëhapur.
- B) Kushedi sa herë i kam vajtur nënës në shtëpi si pulë e lagur.
- C) Na erdhi edhe Vasoja, edhe Gjergji, edhe Todri.
- D) Nuk m'u durua: mbylla sytë e u futa në ujë.

20. Është shprehje frazeologjike grupi foljor:

1 pikë

- A) kalon mbi trup.
- B) m'i ndërronte rrobat.
- C) u futa në ujë.
- D) s'më ra pika.

21. Në fjalinë: "Merr me mend një liqen të bukur, rrethuar me male të larta", fjala të bukur është:

1 pikë

- A) mbiemër.
- B) parafjalë.
- C) ndajfolje.
- D) emër.

22. Renditni tri veprimet e nënës së Yllit, kur ai shkonte i lagur në shtëpi.

3 pikë

23. Identifikoni një fakt dhe një opinion në tekst.

2 pikë

Fakti _____

Opinion _____

24. Shkruani tri-katër fjali për vendlindjen tuaj (vendndodhja, bukuritë e natyrës, vendet historike).

3 pikë

PJESA III

25. Të shkruajmë.
Përshkruani lojën që ju pëlqen më shumë.

6 pikë

Shtjellimi i idesë (a)	Struktura (b)	Stili dhe origjinaliteti (c)	Saktësia gjuhësore (d)	Totali
2	1	1	2	6